



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Gilan Belediyesi

Komuna e Gjiçanit – Njësia e Personelit

Duke u mbështetur në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L – 149, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civilë, Komuna e Gjiçanit, më 27.05.2015 shpallë këtë:

KONKURS I BRENDSHËM PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

-I- Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “Rexhep Elmazi” në Gjiçan

- Pozita : Zv.Drejtor
- Kategoria Funksionale - niveli drejtues
- Niveli i pagës /koeficienti : 7.2

Kohëzgjatja e emërimit : i karrierës

Nëpunësit i raportojnë : Drejtorit Komunal të Arsimit

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zbatimin e ligjshmërisë,
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorë e tjerë të arsimit,
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlikuara të praktikës,
- Caktimin e masave disiplinore ndaj nxënësve,
- Detyrat lidhur me kurrikulumin,
- Planifikimin, udhëheqjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve në Institucion,
- Zhvillimin e një plani afatmesëm dhe aftëgjatë për aktivitetin e Institucionit,
- Qështjet e tjera që rregullohen përmes këtij ligji.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe shkathhtësitet tjera:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit themelor (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore,
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit,
- Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim, (kandidatët me rastin e aplikimit të cilët nuk e posedojnë këtë program, poqëse emërohen drejtor apo zv. drejtor , janë të obliguar që brenda gjashtë muajve të përfundojnë së paku një program për udhëheqje, administrim ose menaxhim).
- Të kenë 3 (tri) vite përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

Dokumentet e nevojshme:

- Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës,
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Portfolion profesionale,

- Letërreferencë nga një institucion publik – kredibil (si Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli drejtues i shkollës , punëdhënësi paraprak , Institucionet e Arsimit të lartë. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuuese për punën dhe angazhimet paraprake.
- Planin zhvëllimor të institucionit edukativo arsimore dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12: arial sipas udhëzimeve të MASHT-it,
- Qertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore,
- Dëshminë se nuk është nën hetime,
- Kopja e letërnjoftimit.

Shënim: Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunësit civil ekzistues në Komunë të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim. Komuna ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda Komunës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjithë komunitetet në Kosovë. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil si dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për avancimin në karrierë të nëpunësve civilë. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ, nr. 8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit në web – faqen e Komunës dhe tabelat e shpalljeve, duke filluar nga data **27.05.2015** deri me datën **03.06.2015**, që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në Gjilan. Aplikacionet që arrin pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë do ti nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.